



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Bashkia Tiranë
Adresa	Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë
Tel/Fax	0035542256799
E-mail	administrative.prokurime@tirana.al
Adresa e Internetit	www.tirana.al

Autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: **“Blerje 4 (katër) bileta udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë –Lisbonë –Tiranë” si më poshtë:**

1. Blerje 2 (dy) bileta udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Lisbonë - Tiranë, si më poshtë:

- Itinerari: Tiranë - Lisbonë -Tiranë
- Nisja nga Tirana drejt Lisbonës do të bëhet në datën 05.09.2021 në drekë pas orës 15.00 dhe mbërritja në Lisbonë para orës 22.30.
- Kthimi nga Lisbona drejt Tiranës do të bëhet në datën 06.09.2021 në darkë. Nisja nga Lisbona në drekë pas orës 15.30 dhe mbërritja në Tiranë në darkë para orës 23.30.
- Me një ndalesë
- Bagazhe të përfshira

2. Blerje 2 (dy) bileta udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Lisbonë - Tiranë, si më poshtë:

- Itinerari: Tiranë - Lisbonë -Tiranë
- Nisja nga Tirana drejt Lisbonës do të bëhet në datën 05.09.2021 në mëngjes pas orës 08.00 dhe mbërritja në Lisbonë para orës 16.00.
- Kthimi nga Lisbona drejt Tiranës do të bëhet në datën 07.09.2021. Nisja nga Lisbona në drekë pas orës 15.30 dhe mbërritja në Tiranë në darkë para orës 23.30.
- Me një ndalesë
- Bagazhe të përfshira

Data e zhvillimit do të jetë **03.09.2021 ora 17.50** në adresën www.app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit), si më poshtë:

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, ***Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar.***

Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për realizimin /mosrealizimin e objektit të prokurimit, brenda 2 orëve nga momenti i njoftimit në sistem, në të kundërt operatori do të s'kualifikohet duke përzgjedhur ofertuesin ekonomik i renditur i dyti në listën e ofertave që kanë mbetur, deri në ofertuesin e renditur në vend të fundit.

**Operatori ekonomik së bashku me itinerarin e ofruar, duhet të paraqesë edhe të dhënat e kontaktit (numër telefoni, e-mail) në sistem. Nëse itinerari i ofruar nga OE është në përputhje me kërkesat e AK dhe sipas destinacionit të kërkuar, Autoriteti Kontraktor pas konfirmimit do të nis të dhënat e personave udhëtues në adresën elektronike (email) të Operatorit ekonomik.*

Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës do të jetë menjëherë elektronikisht (email) brenda 2 orëve duke filluar nga momenti i shpalljes së fituesit.

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij në QKR, objektin e prokurimit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit në sistem.